



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 136, datë 21.09.2019

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT, VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATURAVE PËR VENDIN VAKANT NË GJYKATËN KUSHTETUESE, VAKANCË E PARAKOHSHME, SHPALLUR NGA KUVENDI NË DATËN 21.08.2019 DHE ZHVILLIMIN E SHORTIT PËR CAKTIMIN E ANËTARIT RELATOR TË KED-SË

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, nenit 228 dhe pikës 4 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe pikës 3 të nenit 7/c të ligjit nr.8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019.
2. Zhvillimin e shortit, në mënyrë manuale, për caktimin e anëtarit relator të KED-së në procesin e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI

